

ANALIZA E AFTËSIVE MENAXHERIALE PËRMES EKONOMISË KIBERNETIKE

Shaqir ELEZAJ¹, Robert DIMITROVSKI²

ABSTRAKT

Punimi e shtjellon një qasje të re në lidhje me caktimin e aftësive menaxheriale nga aspekti i Ekonomisë Kibernetike. Modeli bazohet në përcaktimin e fushës operationale konvekse, ashtu që gjendjet ekonomike kufitare të fushës operationale në fjalë janë të caktuara me Menaxhimin Operativ (MO), Menaxhimin Strategjik (MS) dhe Menaxhimin Parashikues (MP). Çfarëdo pikë (gjendje ekonomike) brenda fushës operationale konvekse në realitet i përket Menaxherit të suksesshëm, të i cili, varësisht nga pozita, në përqindje përkatëse janë të shprehura aftësitë udhëheqëse në fjalë. Kjo do të thotë që aftësitë menaxheriale të Menaxherit të suksesshëm në formën adekuate e përcaktojnë formën e funksionit kriterial, ndërsa kufijtë e fushës operationale konvekse i përcaktojnë përkufizimet ndaj funksionit kriterial.

Fjalët Kyçe: Menaxhmenti, Menaxhmenti Operativ, Menaxhmenti Strategjik, Menaxhmenti, Parashikues, Fusha Operationale Konvekse

1. VETITË E MENAXHERIT TË SUKSESHËM

Menaxheri i suksesshëm mund dhe duhet t'i ketë kualitetet e ndryshme përkatëse. Cilësitë themelore të menaxherit të suksesshëm janë:

- aftësia vendimmarrëse,
- aftësia udhëheqëse,
- integriteti personal,
- entuziazmi në udhëheqjen menaxheriale,
- gatishmëria që të punoj shumë,
- aftësitë e rezonimit analitik,
- mirëkuptimi për mendimin e ekipit menaxheria,

¹ **MSc. Shaqir ELEZAJ**, e-mail: shaqir.elezaj@cta-ks.com
CTA sh.p.k., www.cta-ks.com

Tel.: + 386 (0) 49 506 447, Fax: + 381 (0) 39 432 466
Rr. Pjeter Bogdani Nr. 26, 30 000 Peje, Republika e Kosovës

² **Prof. Dr. Robert DIMITROVSKI**, e-mail: robert.dimitrovski@fon.edu.mk
FON University, <http://www.fon.edu.mk>

Tel.: + 389 (0) 2 244 55 55, Fax: + 389 (0) 2 244 55 50
Rr. Vojvodina b.b., 1 000 Shkup, Republika e Maqedonisë

- aftësitë e shprehura për të monitoruar rastet e volitshme,
- aftësitë për t'u ballafaquar më situatat e pakëndshme dhe intriguese,
- aftësitë për t'u përshtatur ndaj situatës së re,
- aftësia për marrjen e riskut të udhëheqjes menaxheriale,
- ndërmarrësia,
- aftësitë e mira komunikuese,
- vlerësimi në vendin dhe momentin e duhur,
- aftësitë e administrimit të suksesshëm,
- përvetësimi i ideve të reja,
- konsekuenca në vendimmarrje menaxheriale,
- gatishmëria të punojë jashtë orarit të punës,
- të jetë ambicioz ,
- aftësia e shkrimit të qartë,
- të jetë kureshtar,
- aftësitë e të menduarit logjistik dhe përparimtar, etj.

Menaxheri i suksesshëm mund të ketë kualitete të ndryshme. Kuptohet, këto veti përfshijnë lëmenj të ndryshëm, dhe kështu menaxheri mund të zhvillojë ndikimin e vet në realizimin e suksesshëm të punës menaxheriale.

Përveç karakteristikave të potencuar më parë, ekzistojnë edhe karakteristikat tjera të dëshiruara, sikurse që janë: të jetë inteligjent, emocionalisht stabil, dominues, i ndërgjegjshëm, i rëndësishëm, dinak në aspektin afarist menaxherial, i kujdesshëm, të jetë i qëndrueshëm në zbatimin e ideve përparimtare menaxheriale, e të ngjashme.

2. PËRCAKTIMI I VETIVE MENAXHERIALE

Në lidhje më zbatimin e modelit për analizën e aftësive menaxheriale, është e përshtatshme që të përcaktohet në mënyrë të përshtatshme fusha operacionale konvekse parimisht sipas Fig. 1.




Fig. 1. Në lidhje me analizën e aftësive menaxheriale

Fusha operationale konvekse parimisht është e dhënë me përkufizimet e aftësive menaxheriale të menaxhimit operativ (MO), menaxhimit strategjik (MS) dhe menaxhimit parashikues (MP). Pozita e menaxherit duhet të jetë brenda fushës operationale përkufizuese, ashtu që mund të jepet:

$$M = \alpha \cdot MO + \beta \cdot MS + (1 - \alpha - \beta) \cdot MP \quad (1)$$

ashtu që koeficientet α dhe β duhet të plotësojnë kushtet:

$$0 \leq \alpha \leq 1; \quad 0 \leq \beta \leq 1 \quad (2)$$

Për shembull, për konditat:

$$5 = \alpha \cdot 2 + \beta \cdot 7 + (1 - \alpha - \beta) \cdot 3; \quad 3 = \alpha \cdot 1 + \beta \cdot 2 + (1 - \alpha - \beta) \cdot 7 \quad (3)$$

përfitohet:

$$M = \frac{6}{29} \cdot MO + \frac{16}{29} \cdot MS + \frac{7}{29} \cdot MP$$

(4)

Efikasiteti i zbatimit të aftësive menaxheriale është:

$$AM = \frac{1}{2} \begin{vmatrix} 2 & 1 & 1 \\ 7 & 2 & 1 \\ 3 & 7 & 1 \end{vmatrix} = \frac{29}{2}$$

(5)

Më tutje mund të caktohen aftësitë menaxheriale ndër sektoriale. Kështu, p.sh. ndaj fushës operationale konvekse M-MO-MS, aftësitë menaxheriale janë:

$$AM_1 = AM \cdot (M - MO - MS) = \frac{1}{2} \cdot \begin{vmatrix} 2 & 1 & 1 \\ 7 & 2 & 1 \\ 5 & 3 & 1 \end{vmatrix} = \frac{7}{2}$$

(6)

Në mënyrë analoge përcaktohen aftësitë menaxheriale ndër sektoriale:

$$AM_2 = AM \cdot (M - MS - MP) = \frac{1}{2} \cdot \begin{vmatrix} 7 & 2 & 1 \\ 3 & 7 & 1 \\ 5 & 3 & 1 \end{vmatrix} = 3$$

(7)

$$AM_3 = AM \cdot (M - MP - MO) = \frac{1}{2} \cdot \begin{vmatrix} 3 & 7 & 1 \\ 2 & 1 & 1 \\ 5 & 3 & 1 \end{vmatrix} = 8$$

(8)

Kështu, mund të përfitohet:

$$\frac{AM_1}{AM} = \frac{7}{29} = 24.138\%; \quad \frac{AM_2}{AM} = \frac{6}{29} = 20.690\%; \quad \frac{AM_3}{AM} = \frac{16}{29} = 55.172\%$$

(9)

Kjo do të thotë që aftësitë menaxheriale AM_1 të menaxherit të suksesshëm (brenda fushës operationale konvekse $M-MO-MS$) janë të barabarta më 24.138% ndaj aftësive menaxheriale të menaxherit, kur në konsideratë merren aftësitë menaxheriale ndër sektoriale operative dhe ato strategjike (për rastin e analizuar). Në mënyrë analoge përcaktohen edhe madhësitë e aftësive menaxheriale ndër sektoriale $AM_2 = 20.690\%$ dhe $AM_3 = 55.172\%$. Kuptohet, për ndonjë pozitë tjetër të menaxherit brenda fushës operationale konvekse $MO-MS-MP$ (për të gjitha pikatë, përkatësisht gjendjet ekonomike brenda fushës operationale konvekse) mund të caktohen vlerat përkatëse për AM, AM_i ($i = 1, 2, 3$).

Sipas analizës të Ekonomisë Kibernetike, njëra nderë madhësitë më të rëndësishme gjithsesi është edhe koeficienti i elasticitetit (ε).

Kështu, për fushën operationale konvekse $MO-MS-MP$ koeficienti i elasticitetit respektivisht është:

$$\varepsilon = \frac{2Q \cdot (45Q^2 - 223Q - 233)}{3 \cdot (Q + 3)(5Q - 43) \cdot (6Q - 11)} \quad (10)$$

e cila madhësi është caktuar si mesatarja e thjeshtë aritmetike ndaj proceseve ekonomike $MO-MS, MS-MP$ dhe $MP-MO$. Dihet që në rastin e përgjithshëm, koeficienti i elasticitetit $\varepsilon(Y, X)$ ndërmjet dy madhësive ekonomike X (variabla ekonomike e pavarur) dhe Y (variabla ekonomike e varure) përcaktohet sipas:

$$\varepsilon(Y, X) = \frac{\partial Y}{\partial X} \frac{X}{Y} \quad (11)$$

Në Fig. 2 grafikisht është prezantuar koeficienti i elasticitetit për fushën operationale konvekse $MO-MS-MP$. Për shembull, për $Q = 4$ sipas diagramit përfitohet $\varepsilon = 0.5$, çdo të thotë që kur prodhimtaria (Q) ndryshon për 1%, atëherë çmimi i produktit (P) rritet (shenja plus) për 0.5%, e ndaj aftësive menaxheriale operative, strategjike dhe parashikuese të menaxherit, dhe kështu më radhë.

Në mënyrë analoge respektivisht mund të caktohen edhe koeficientet e elasticitetit ndër sektoriale $\varepsilon_1, \varepsilon_2$ dhe ε_3 , gjithashtu si mesatarët e thjeshta aritmetike:




Fig. 2. Koeficienti i elasticitetit ndaj fushës operationale konvekse MO-MS-MP

Në Fig. 3 grafikisht është prezantuar raporti $\varepsilon_1/\varepsilon$ i koeficientit të elasticitetit ε_1 të fushës operationale konvekse M-MO-MS ndaj koeficientit të elasticitetit ε të fushës operationale konvekse MO-MS-MP.




Fig. 3. Prezantimi grafik i raportit $\varepsilon_1/\varepsilon$ të koeficienteve përkatës të elasticiteteve

Për shembull, për $Q = 5.5$ nga diagrami përfitohet $\varepsilon_1/\varepsilon = 2$, çdo të thotë që kur prodhimtaria (Q) ndryshon për 1%, çmimi i produktit (P) rritet (shenja plus) për 2%, e ndaj herësit $\varepsilon_1/\varepsilon$ për aftësitë përkatëse të menaxherit ndaj fushës operacionale ndër sektoriale M - MO - MS dhe fushës operacionale konvekse MO - MS - MP .

$$\begin{aligned}\varepsilon_1 &= \frac{2Q(3Q^2 - 17Q - 29)}{2(Q+3)(2Q-1)(Q-11)} \\ \varepsilon_2 &= \frac{2Q(5Q^2 - 87Q + 370)}{(2Q-13)(Q-11)(5Q-43)} \\ \varepsilon_3 &= \frac{2Q(36Q^2 - 212Q + 193)}{3(2Q-1)(2Q-13)(6Q-11)}\end{aligned}\quad (12)$$

Në Fig. 4 grafiksht është prezantuar raporti $\varepsilon_2/\varepsilon$ i koeficientit të elasticitetit ε_2 të fushës operacionale konvekse M - MS - MP ndaj koeficientit të elasticitetit

ε të fushës operationale konvekse MO-MS-MP. Për shembull, për $Q = 4$ nga diagrami përfitohet $\varepsilon_2/\varepsilon = -2$, çdo të thotë që kur prodhimtaria (Q) ndryshon për 1%, çmimi i produktit zvogëlohet (shenja minus) për 2%, e ndaj herësit $\varepsilon_2/\varepsilon$ për aftësitë përkatëse të menaxherit ndaj fushës operationale ndër sektoriale M-MS-MP dhe fushës operationale konvekse MO-MS-MP.




Fig. 4. Prezantimi grafik i raportit $\varepsilon_2/\varepsilon$ të koeficienteve përkatës të elasticiteteve

Në Fig. 5 grafikisht është prezantuar raporti $\varepsilon_3/\varepsilon$ i koeficientit të elasticitetit ε_3 të fushës operationale konvekse M-MP-MO ndaj koeficientit të elasticitetit ε të fushës operationale konvekse MO-MS-MP. Për shembull, për $Q = 4$ nga diagrami përfitohet $\varepsilon_3/\varepsilon = 0.9$, çdo të thotë që kur prodhimtaria (Q) ndryshon për 1%, çmimi i produktit (P) rritet (shenja plus) për 0.9%, e ndaj herësit $\varepsilon_3/\varepsilon$ për aftësitë përkatëse të menaxherit ndaj fushës operationale ndër sektoriale M-MP-MO dhe fushës operationale konvekse MO-MS-MP. Për këtë rast mund të potencohet që mund të caktohet edhe vlera maksimale, $(\varepsilon_3/\varepsilon)_{\max} = 1.160$ për $Q = 2.719$.

Nga aspekti i Ekonomisë Kibernetike është më rëndësi, ndërmjet tjerave, të caktohet edhe benefiti (përfitimi) përkatës. Benefitit mund të caktohet sipas

varësisë primore, $B = Q \cdot P$, ashtu që për analizën në fjalë, ndaj fushave operacionale konvekse repere, respektivisht përfitohet:

$$B = \frac{33}{20} \cdot Q^2 + \frac{7}{60} \cdot Q ; B_1 = \frac{11}{90} \cdot Q^2 + \frac{173}{90} \cdot Q ;$$

$$B_2 = -\frac{5}{4} \cdot Q^2 + \frac{39}{4} \cdot Q ; B_3 = \frac{14}{9} \cdot Q^2 + \frac{5}{9} \cdot Q$$

(13)




Fig. 5. Prezantimi grafik i raportit $\varepsilon_3/\varepsilon$ të koeficienteve përkatës të elasticiteteve

Benefitët përkatëse grafikisht janë prezantuar sipas Fig. 6. Për shembull, të benefiti B_2 , ndaj fushës operacionale konvekse M - MS - MP mund të caktohet edhe vlera maksimale, $B_{2(max)} = 1521/80 = 19.013$, e cila arrihet për $Q = Q_e = 39/10 = 3.9$.




Fig. 6. Prezantimi grafik i benefiteve B dhe B_i ($i=1, 2, 3$)

Në Fig. 7 grafikisht janë prezentuare raportet përkatëse të benefiteve, B_i/B ($i = 1, 2, 3$) si herësat ndërmjet benefiteve ndër sektoriale ndaj benefitit për fushën operationale konvekse $MO-MS-MP$. Për shembull, për $Q = 3.5$ është $B_1/B = 0.4 = 40\%$, dhe kështu më radhë.

Kuptohet, sipas analizës në fjalë, mund të caktohen edhe parametrat tjerë karakteristikë sipas Ekonomisë Kibernetike, e ndaj analizës moderne të proceseve dhe cikleve ekonomike.




Fig. 7. Raportet përkatëse të benefiteve B_i/B ($i = 1, 2, 3$)

3. KONKLUZIONE

Analiza e prezantuar, përmes Ekonomisë Kibernetike, në realitet bazohet në shtjellimin e proceseve dhe cikleve ekonomike në mënyrë moderne. Funkzioni kriterial dhe përkufizimet përkatëse janë të përcaktuara sipas formësimit të fushës operacionale konvekse. Në rastin e analizuar fusha operacionale konvekse është e përcaktuar më gjendjet ekonomike të menaxhimit operacional (MO), menaxhimit strategjik (MS) dhe atij parashikues (MP). Analiza në fjalë në mënyrë të ndërsjellët mund të ndërlidhet edhe më programimin linear dhe atë jolinear.

4. LITERATURA

- Ayres C. E. (1962). *The theory of economic progress*, New York,
 Elwood, Buffa S. (1973): *Modern Production Management*, John Wiley and Sons, Toronto,
 Dimitrovski R. (2010): *Proekt Menadzement*, FON, Skopje,
 Donnelly J., Gibson J., Ivancevich J. (1987): *Fundamentals of Management*, New York,
 Drucker P. (1987): *The practice of management*, New York,
 Koleci B., Turkeshi N. (2008): *Bazat e Menaxhimit*, Shkup,
 Stewart R. (1982): *The reality of management*, New York.